

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-033/13**

**Prishtinë, 21 janar 2014**

Në çështjen juridike të:

**B. S.**  
Prishtinë

*Pala përgjegjëse në kërkesë/Pala ankuese*

kundër

**G. (M.) L.**  
Kurshumli

**Serbi**

*Paraqitësi i kërkesës/Pala përgjegjëse në ankesë*

Kolegji i Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët: Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, Dag Brathole dhe Sylejman Nuredini, Anëtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/155/2012 (lënda është regjistruar në AKP me numrat KPA37059 dhe KPA37060), të datës 6 qershor 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 21 janar 2014, mori këtë

## **AKTGJYKIM**

- 1- Lëndët GSK-KPA-A-033/13 dhe GSK-KPA-A-034/13 bashkohen në lëndën GSK-KPA-A-033/13.**
- 2- Refuzohen si të pabazuara ankesat e B. S.**
- 3- Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/155/2012 (për sa i përket lëndëve të regjistruara në AKP me numrat KPA37059 dhe KPA37060), i datës 6 qershor 2012.**

### **Bashkimi i lëndëve:**

1. Neni 408.1 i Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK) parasheh që gjykata mund t'i bashkojë të gjitha lëndët kur dy a më tepër procedura gjyqësore janë në vazhdim e sipër në të njëjtën gjykatë dhe që përfshijnë personat e njëjtë, nëse kjo do të siguronte efektivitetin dhe efikasitetin e gjykatës në atë lëndë.
2. Në lëndët e regjistruara me numrat GSK-KPA-A-033/13 dhe GSK-KPA-A-034/13, pala ankuese ka paraqitur ankesa identike, duke dhënë shprehimisht pëlqimin e tij për bashkimin e lëndëve, siç parashihet me nenin 408.3 të LPK-së. Përveç kësaj, Gjykata Supreme vëren se faktet, bazat ligjore dhe çështjet e të provuarit janë plotësisht të njëjta në këto lëndë. Vetëm ngastrat, që janë objekt i së drejtës pronësore që pretendohet në çdo kërkesë, janë të ndryshme. Pala përgjegjëse në ankesë po ashtu është personi i njëjtë. Ankesat bazohen në të njëjtën deklaratë sqaruese dhe në të njëjtin dokumentacion. Për më tepër, vendimi i kundërshtuar grupor i KKPK-së është i njëjtë.
3. Pasi që të gjitha elementet e gjertanishme, përveç ngastrave, janë të njëjta, është e qartë se është më efikase që ankesat të bashkohen dhe ato të shqyrtohen në një aktgjykim të vetëm.
4. Lëndët e lartpërmendura bëhen një lëndë e vetme e regjistruar me numrin GSK-KPA-A-033/13.

### **Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:**

5. Më 7 maj 2007, G. (M) L. ka paraqitur kërkesa në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku ka kërkuar ri-posedimin e parcelave me numrat 1207, 1208 (të dyja me sipërfaqe prej 73 ari e 1 m.k), 1209, 1210 dhe 1211 (të trija me sipërfaqe prej 79 ari e 37 m.k). Ngastrat gjenden në vendin e quajtur “Stara pleća” në Rimanishtë, Prishtinë. Ai ka pohuar se është pronar i ngastrave dhe se toka ishte uzurpuar nga një person i panjohur. Ai e kishte humbur posedimin me 18 qershor 1999. Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur në AKP fletën poseduese nr. 103, të lëshuar në vitin 2002 nga Agjencia Kadastrale e Kosovës. Sipas operatit kadastral, pronat e kërkuara kishin qenë të regjistruara në emër të G. (M) L. Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur vendimin mbi trashëgiminë – T. nr. 129/2002 të datës 13 maj 2002 (që vërteton të drejtat e tij trashëgimore ndaj pronave), skemat kadastrale të ngastrave dhe një certifikatë të vitit 1937 e cila ka të bëjë me blerjen e supozuar të pronave të njëjta. Pretendohet se stërgjyshi i paraqitësit të kërkesës i kishte blerë këto prona nga stërgjyshërit e palës përgjegjëse në kërkesë B.S.. AKP-ja i ka verifikuar pozitivisht këto dokumente. Paraqitësi i kërkesës pohon se asnjëra nga pronat nuk ishte shitur më vonë dhe se familja e tij i kishte shfrytëzuar ato deri në vitin 1999 kur ata është dashur të largohen nga Kosova.
6. Pas njoftimit, B. S. është përgjigjur në kërkesa. Ai ka deklaruar se ai e jo paraqitësi i kërkesës është bartës i së drejtës pronësore. Ai ka pretenduar se stërgjyshi i tij I. I. i kishte blerë pronat e kërkuara. Ai ka paraqitur një dokument të quajtur “Obligim”, në të cilin ceket se P. S. e kishte huazuar nga I. I. një shumë parash dhe në rast se nuk do t’ia kthente paratë, I. do të mund të merrte njërin nga livadhet e tij. Nuk ka të dhëna për një bartje pasuese të pronës.
7. As dokumenti i vitit 1937, i paraqitur nga paraqitësi i kërkesës, e as dokumenti i vitit 1929, dorëzuar nga pala përgjegjëse në kërkesë, nuk kanë dhënë një identifikim të qartë (në kontekst të kadastrit aktual) të ngastrave të tokës të cilave iu referohen. Të dy dokumentet përmbajnë ilustrime përshkruese të pjesëve të tokës duke shpjeguar se me çka kufizoheshin në kohën e hartimit të këtyre dokumenteve - viti 1929 dhe 1937. Megjithatë, nuk ka të dhëna në dosje se pronat e përshkruara në këto dokumente të vjetra korrespondojnë me pronat e kërkuara. Nuk ekzistojnë as të dhëna nëse është bërë verifikimi kadastral në lidhje me këtë.
8. Pavarësisht nga ajo që u cek me lartë, nuk është kontestuese se së paku që nga fillimi i viteve 1940 e deri në vitin 1999, pronat e kërkuara, më saktësisht ngastrat 1207, 1208, 1209, 1210 dhe 1211 ishin shfrytëzuar nga familja e paraqitësit të kërkesës G. (M.) L. dhe se B.S. dhe familja e tij kishin hyrën në posedim të asaj toke vetëm pasi që paraqitësi i kërkesës ishte larguar nga Kosova për shkak të konfliktit të armatosur, që do të thotë pas vitit 1999 e tutje.

9. Po ashtu ka argumente se pas vitit 1999, paraqitësi i kërkesës asnjëherë nuk ia kishte shitur pronat e tij palës përgjegjëse në kërkesë apo dikujt tjetër.
10. Më 6 qershor 2012, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) me vendimin e vet KPCC/D/A/155/2012 ka pranuar kërkesat. Komisioni ka konsideruar se paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një fletë poseduese që atë e cek si bartës të së drejtës pronësore. Dokumenti ishte verifikuar pozitivisht dhe se pronat asnjëherë nuk janë shitur. Sa i përket palës përgjegjëse në kërkesë, Komisioni nuk i ka pranuar pretendimet se pronat ishin blerët nga një person i tretë në vitin 1941.
11. Vendimi i është dorëzuar palës përgjegjëse në kërkesë më 4 janar 2013. Më 8 janar 2013, pala përgjegjëse në kërkesë (këtej e tutje: pala ankuese) ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, duke kundërshtuar vendimin e KKPK-së. Ai nuk thirret në zbatimin e gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale. Ai thekson se vendimi është i padrejtë. Ai pretendon se stërgjyshi i tij I. S. asnjëherë në jetën e tij nuk kishte nënshkruar ndonjë kontratë që më vonë do të shfrytëzohej si dëshmi e shitblerjes nga L. G.. Ky i fundit i kishte përgatitur krejtësisht vetëm dokumentet në mungesë të familjes së tij. Nuk është e qartë se cilat dokumente i përshkruan pala ankuese, por nga deklaratat e mëhershme të palëve, mund të konkludohet se pala ankuese i referohet bartjes së supozuar të pronave në të kaluarën – në vitin 1937. Pala ankuese ka paraqitur deklaratat me shkrim të nënshkruara nga tre persona të ndryshëm, të lindur në vitet - 1943, 1932 dhe 1963. Pala ankuese ka paraqitur edhe padinë të cilën e kishte paraqitur kundër L. G. me 23 mars 2007 në Gjykatën Komunale të Prishtinës, ku ka kërkuar nga Gjykata Komunale që t'ia njoh drejtën pronësore ndaj disa pronave, mes të cilave edhe atyre të kontestuar. Nuk ka të dhëna nëse gjykata e rregullt e ka pushuar procedurën apo ajo ende është në pritje.
12. Paraqitësi i kërkesës në përgjigjen e tij në ankesë e mbështet deklaratën e tij fillestare se familja e tij i kishte shfrytëzuar pronat pandërprerë nga viti 1937 deri në vitin 1999. Ai potencon se dëshmitarët, deklaratat e të cilëve janë paraqitur nga pala ankuese, ose nuk kanë qenë të lindur fare ose kanë qenë shumë të rinj për të qenë në gjendje të dëshmojnë për faktet që kanë ndodhur në vitin 1937.

**Arsyetim ligjor:**

13. Ankesa është pranueshme. Ajo është paraqitur brenda afati prej 30 ditës të përcaktuar me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

14. Lënda është në kuadër të fushëveprimit të juridiksionit të KKPK-së dhe Kolegjit të Apelit të AKP-së. Nuk ka dyshim se paraqitësi i kërkesës dhe familja e tij i kishin poseduar pronat deri në vitin 1999, kur iu është dashur të largohen nga Kosova. Fakti se pala ankuese ka paraqitur padi në Gjykatën Komunale të Prishtinës nuk ndikon në çështjen e juridiksionit, pasi që padia në gjykatën civile ishte paraqitur më 23 mars 2007, dmth. pas hyrjes në fuqi të Rregullores së UMMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, (*Ligji*). Neni 18 i *Ligjit* thekson se dispozita e këtij *Ligji* zbatohen për paditë sipas nenit 3.1 *po aty* në rastet kur procedurat gjyqësore lidhur me ato padi nuk kanë filluar para hyrjes në fuqi të këtij *Ligji*. Procedura gjyqësore në Gjykatën Komunale e iniciuar nga B. S. kundër L. G. në lidhje me të drejtën pronësore ndaj ngastrave të njëjta është iniciuar pas hyrjes në fuqi të këtij *Ligji*.
15. Ankesa është e pabazuar. Vendimi i KKPK-së është i drejtë; Gjykata gjen se nuk ka pasur vërtetim jo të plotë të fakteve e as zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale. Pasi që nuk ka argument se pronat e kontestuara kanë qenë në posedim të pandërprerë të familjes së palës përgjegjëse në ankesë për së paku që nga fillimi i viteve 1940 e deri në vitin 1999 dhe nuk ka pasur ndonjë bartje të pronës të regjistruar para apo pas vitit 1999 në favor të palës ankues (apo të anëtarëve të familjes së tij), nuk ka arsye që Gjykata ta anulojë apo ndryshojë vendimin e KKPK-së me të cilin kërkesa është pranuar si e bazuar.
16. Prandaj, në përputhje me nenin 13.3 të Ligjit, Gjykata e refuzon ankesën dhe e konfirmon vendimin.

### **Udhëzim juridik**

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet me mjete të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike.

***Elka Filcheva, Kryetare e Kolegjit, EULEX***

***Sylejman Nuredini, Gjyqtar***

***Dag Brathole, Gjyqtar i EULEX-it***

***Urs Nufer, Referent i EULEX-it***